



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/543
Datë: 22 10 2021

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23, paragrafi 1.6, paragrafi 1.6.2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe UA 12/2007 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.10.2021, miratoi:

RREGULLORE

Për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë çështjet e të ardhurave personale dhe kompensimit të punës për personelin akademik në marrëdhënie pune të rregullt apo të angazhuar në UP, shtesat sipas funksioneve, si dhe kompensimin e punës së anëtarëve të komisioneve të specifikuar në këtë rregullore, të cilat emërohen brenda UP-së, duke mos përjashtuar edhe çështjet e tjera që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në të ardhurat personale, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në Universitetin e Prishtinës.

Neni 2

Burimet dhe mënyra e financimit

1. Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i buxhetit të Republikës së Kosovës, tarifat e shkollimit dhe pagesat e tjera të studentëve, pagesat e shërbimeve komerciale, donacionet dhe nga kontratat me mekanizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, publik dhe privat.
2. Nga burimet financiare të pasqyruara në pikën 1 paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet e tjera të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimeve tjera, puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të rregullt dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

3. Lartësia e të ardhurave personale caktohet në bazë të koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat, sipas kodimit unik për tërë arsimin në Kosovë.
4. Shërbimi për financa i UP-së e bën përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera, në bazë të vendimeve dhe kontratave të organeve të UP-së. Mbi këtë bazë menaxhmenti i UP-së jep urdhër për realizimin e pagesave sipas vendimeve dhe kontratave, të cilat lidhen me të punësuarit, me rastin e angazhimit.

Neni 3 Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Për nevoja të kësaj rregulloreje përkufizimet e mëposhtme dhe shkurtesat e kanë kuptimin si në vijim:

1.1. Përkufizimet

- **Bashkëpunëtor i jashtëm** - personeli i jashtëm i angazhuar në UP, respektivisht, mësimdhënësit, lektorët dhe asistentët e angazhuar, të cilët nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune me UP-në ose kanë pezulluar marrëdhënien e punës në UP (sipas ligjeve në fuqi dhe vendimeve të organeve të UP-së) dhe angazhohen me një fond të caktuar të orëve, duke respektuar kriteret dhe procedurat, të përcaktuara me statut dhe rregulloret në fuqi, përfshirë edhe mësimdhënësit dhe lektorët që angazhohen në kuadër të bashkëpunimit me ambasada dhe agjenci shtetërore të vendeve përkatëse si: USAID, DAAD, OEAD por edhe agjenci shtetërore të shteteve të tjera, të cilët kanë bashkëpunim me njësitë akademike të UP-së;
- **Mbinormë** - fondi i orëve të angazhimit që tejkalojnë orët e përcaktuara të normës për mësimdhënësit dhe asistentët e rregullt të UP-së, sipas kontratës së veçantë;
- **Normë** - fondi i orëve të rregullta në UP për mësimdhënësit dhe asistentët e rregullt, e cila pasqyrohet edhe në kontratën e punës;
- **Post publik** - posti i të zgjedhurit apo të emëruarit në një funksion publik. Të zgjedhurit; anëtarët e qeverisë dhe zëvendësit e tyre; funksionarët e emëruar nga kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura; drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatorë;
- **Profesor vizitor** – profesor nga institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë, i ftuar për të mbajtur ligjërata ose cikël ligjëratash në Universitetin e Prishtinës;
- **Studime të integruara** - masteri i integruar u referohet dy gradave të unifikuara së bashku, në thelb një diplomë bachelori dhe një master, pra studenti ka mundësi të përfundojë studimet në vitin e tretë apo të katërt, me ç'rast akumulon 180/240 ECTS-kredi dhe merr titullin bachelori, gjithashtu studimet mund t'i vazhdojë pa shkëputje për pesë vjet, me ç'rast akumulon 300 ECTS-kredi dhe merr titullin master.

1.2. Shkurtesat

- **FBV** - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- **FEFS** - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit;
- **FIEK** - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
- **FIM** - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- **FSHMN** - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore;
- **MASHTI** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- **PROF. DR.** - Profesor i rregullt;
- **PROF. ASOC. DR.** - Profesor i asocuar;
- **PROF. ASS. DR.** - Profesor asistent;
- **ASS.** - Asistent universiteti;
- **SEMS** - Sistemi elektronik i menaxhimit të studentëve të UP-së;
- **UP** - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”;

II. DISPOZITAT MATERIALE, ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE

Neni 4

Marrëdhënia e punës e personelit akademik sipas normës

1. Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës, në pajtim me ligjet në fuqi, lidhet kontratë pune:
 - 1.1. Me normë të plotë,
 - 1.2. Me gjysmënormë dhe
 - 1.3. Me mbinormë.
2. UP-ja, sipas marrëveshjes, lidh kontratë pune me honorar me bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, duke u bazuar në rregulloret në fuqi brenda UP-së.
3. Në kuadër të marrëdhënies së punës për normë të plotë, përpos normës së ligjëratave dhe ushtrimeve për personelin akademik, sipas kontratës (40 orë në javë) hyjnë edhe angazhimet si në vijim: përgatitja e ligjëratave, ushtrimeve, mbikëqyrja e punimeve të diplomës dhe seminareve në studimet baçelor dhe master, si dhe pjesëmarrja në komisione, përgatitja dhe

mbajtja e provimeve dhe konsultimeve si dhe detyra dhe angazhime të tjera, bazuar në aktet në fuqi të UP-së.

4. Marrëdhënia e punës me normë të plotë ose angazhimet me mbinormë si dhe angazhimet e tjera bëhen sipas vendimeve të organeve kompetente të UP-së, si dhe kontratave të lidhura në mes të UP-së dhe personelit akademik.
5. Personelit akademik që i ka përfunduar kontrata e punës (*kategorisë së mësimdhënësve sipas nenit 176 dhe 177 të statutit në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, kurse asistentëve, lektorëve dhe korepetitorëve sipas nenit 178 dhe 179 në kohëzgjatje prej 3 vjetësh*) si pasojë e shtyrjes, përkatësisht vonesave në përfundimin e procedurave të rizgjedhjes apo avancimit, i vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale për një (1) vit akademik, përkatësisht deri në përfundim të procedurave të konkursit, përkatësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e senatit lidhur me konkursin përkatës.

Neni 5

Kufizimet në marrëdhënien e punës sipas normës

1. Kriteret e kufizimeve përkitazi me marrëdhënien e dytë të punës caktohen me statut dhe në bazë të akteve të tjera, të cilat nxjerrën nga organet kompetente të UP-së, duke u bazuar në legjislacionin relevant në fuqi.

Neni 6

Sanksionet financiare për mospërbushje të detyrave

1. Personeli akademik i cili pa arsye mungon nga procesi mësimor, mbajtja e provimeve dhe kujdestarisë do të sanksionohet me heqje të pagës si në vijim:
 - 1.1. për profesor: 1 (një) orë 50 €;
 - 1.2. për asistent, lektor dhe korepetitor: 1 (një) orë 25 €.
2. Dekani i njësisë akademike obligohet që të procedojë për zbatim sanksionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni. Nëse dekani nuk raporton për orët e humbura ose për mosmbajtje të provimit brenda afatit të shpallur do të sanksionohet me 50% të vlerës së shtesës funksionale.
3. Personeli akademik dhe menaxhues sanksionohet me heqje 10% të pagës bazë, nëse ai/ajo nuk merr pjesë pa arsye në mbledhje të senatit, kolegjiut të dekanëve, këshill të fakultetit, departamente dhe në komisione, në të cilat është emëruar nga organet e UP-së apo njësitë akademike.
4. Rektori për anëtarët e senatit dhe kolegjiut të dekanëve, respektivisht dekani i njësisë akademike, pas konsultimeve me rektorin, obligohet që të zbatojë sanksionet e përcaktuara sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 7
Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik

1. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt punë në UP përcaktohet norma e orëve javore të mësimit, numrit të punimeve të diplomave të studimeve themelore dhe të masterit dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik.
2. Baza ligjore për ndryshim të pagës bazë të specifikuar në tabelën 1 të këtij neni, në raport me pagën e cila ka qenë e përcaktuar sipas nenit 8, tabela nr. 1 të rregullores nr. 2-486-11.9.2017, mbështetet në Vendimin nr. 05/24, datë 12.01.2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritje të pagë bazë në lartësi prej 4%.
3. Norma e plotë e orëve javore të mësimit për personelin akademik dhe pagesa përkatëse është si në vijim:

Tabela 1.

Titulli	Norma e plotë e orëve javore të mësimit	Paga mujore bruto për normë të plotë të orëve javore
Profesor i rregullt	6	1,486.72
Profesor i asocuar	6	1,334.67
Profesor asistent	6	1,182.62
Ligjërues ¹	6	1,030.58
Lektor	10	878.52
Korepetitor	16	878.52
Asistent	10	803.40

4. Përjashtimisht nga Tabela 1 e këtij neni, për personelin akademik të punësuar në Fakultetin e Arteve të Bukura norma javore e orëve do të jetë si në vijim:
 - 4.1. Mësimdhënësit: 10 orë në javë;
 - 4.2. Asistentët: 16 orë në javë.
5. Norma e temave për mentorin dhe anëtarin e komisionit në kuadër të normës dhe me pagesë në nivelin e studimeve baçelor dhe master përcaktohet sipas specifikave të njësive akademike, të përcaktuar në këtë rregullore.
6. Me qëllim të kompensimit dhe implikimeve buxhetore, kusht për shpalljen e konkursit për vendet e reja në UP, për mësimdhënësit, asistent, lektor dhe korepetitor është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër, ligjërata në lëndët zgjedhore ose në Fakultetin e Mjekësisë nga praktika klinike. Norma e plotë llogaritet për një vit akademik.

¹ Vetëm për thirrjet e mbetura, pasi që nuk janë kategori e përcaktuar me statutin në fuqi të UP-së.

7. Në kuadër të kompensimit për normën e rregullt, asistentit dhe lektorit, me gradë shkencore doktor i shtohet edhe një pagesë në lartësi prej 100 € mbi pagën bazë të përcaktuar në këtë rregullore.
8. Nëse mësimdhënësit, që është në marrëdhënie të rregullt pune në UP gjatë procesit mësimor, për arsye të caktuara (ndryshim i planprogramit etj.), i zvogëlohet fondi i orëve, respektivisht nuk mund t'i plotësohet norma e plotë e orëve të ligjëratave, atë mund ta plotësojë edhe me orë të ushtrimeve në përpjesëtim 1 me 1, por jo më shumë se 1/3 e orëve të normës së mësimdhënësit për semestër.

Neni 8

Kompensimi për orët mbi normë të personelit akademik

1. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP, në përputhje me këtë rregullore, i takon kompensimi për çdo orë të mbajtur mbi normë, si më poshtë:

Tabela 2.

Nr. rendor	Emërtimi i thirrjes	Vlera në bruto
1	Për profesorët e universitetit (Prof. i rregullt, prof. asoc. dhe prof. ass.)	25 €
2	Për ligjërues, lektor	15 €
3	Për korepetitor dhe asistent	13 €

2. Në përputhje me Vendimin nr. 03/13, dt. 27.03.2008 të Qeverisë së Kosovës, personelit akademik mësimdhënëses në Universitetin e Prishtinës që ka mbushur moshën 65-vjeçare, pasi të ketë filluar viti shkollor, i vazhdohet kontrata e punës deri në përfundim të vitit akademik.
3. Mësimdhënësi i pensionuar në UP, me rastin e vazhdimit të angazhimit si bashkëpunëtor i jashtëm do të kompensohet për çdo orë të mbajtur, si në pikën 1 të tabelës 2 të këtij neni dhe sipas kufizimeve të caktuara me këtë rregullore.
4. Mësimdhënësi në marrëdhënie të rregullt pune, sipas vlerësimit të njësisë akademike përkatëse dhe duke pasur parasysh nevojat, mund të mbajë orë mbi normë edhe ushtrime, por jo më shumë se 3 orë për semestër, të cilat kompensohen si orë të ligjëratave, ashtu siç është përcaktuar në këtë rregullore. Mbinorma në këtë rast duhet të arsyetohet nga dekani i njësisë akademike dhe të miratohet nga rektori si dhe nuk mund të tejkalojë limitin e mbinormës që është përcaktuar me këtë rregullore. Mbinorma me ushtrime mund të llogaritet vetëm pasi mësimdhënësi ta ketë plotësuar normën me ligjëratat dhe vetëm atëherë kur orët përkatëse nuk mund të mbulohen nga asistentët.
5. Orët mbi normë nuk mund të barten prej një semestri në semestrin tjetër. Me rastin e caktimit dhe kompensimit të mbinormës për vitin akademik, paraprakisht duhet të plotësohet norma për vit akademik. Pasi të jetë plotësuar norma e personelit akademik në kuadër të programit/departamentit, orët e mbetura mund të kompensohen si orë mbi normë.

Neni 9

Punimi i diplomës baçelor dhe master në kuadër të normës

1. Numri i punimeve të diplomës në studimet baçelor në kuadër të normës brenda vitit akademik bëhet sipas specifikave të njësive akademike, të përcaktuara në tabelën 3.

Tabela 3.

Njësia akademike/ Fakulteti	Mentor	Kryetar dhe anëtar
Filozofik	10	20
FSHMN	5	10
Filologjik	10	20
Juridik	10	20
Ekonomik	10	20
Ndërtimtari	5	10
FIEK	5	10
FIM	5	10
Mjekësisë	5	10
FBV	5	10
Artet e Bukura	5	10
FEFS	5	10
Edukim	10	20
Arkitekturë	5	10

2. Numri i punimeve të diplomës në studimet master në kuadër të normës brenda vitit akademik, bëhet sipas specifikave të njësive akademike të përcaktuara në tabelën 4.

Tabela 4.

Njësia akademike/ Fakulteti	Mentor	Kryetar	Anëtar
Filozofik	4	3	3
FSHMN	2	3	3
Filologjik	4	3	3
Juridik	4	3	3
Ekonomik	4	3	3
Ndërtimtari	2	3	3
FIEK	2	3	3
FIM	2	3	3
Mjekësisë	2	3	3
FBV	2	3	3
Artet e Bukura	2	3	3
FEFS	2	3	3
Edukimit	4	3	3
Arkitekturë	2	3	3

3. Mësimdhënësi i emëruar si mentor, pavarësisht pozitave tjera, në të cilat mund të emërohet në komisione lidhur me punimin e kandidatit, kompensohet vetëm në cilësinë e mentorit. Emërimet e tilla të mentorit po ashtu nuk mund të merren parasysh në aspektin e numrit të pjesëmarrjeve në cilësinë e kryetarit/anëtarit si në tabelën 4.
4. Personeli akademik, i cili në momentin e plotësimit të moshës së pensionimit ka qenë në marrëdhënie pune në UP, me rastin e vazhdimit të angazhimit kompensohet për numrin e temave, në të cilat është mentor, anëtar ose kryetar i komisionit. Me qëllim të kompensimit, numri i temave dhe kufizimet tjera, në të cilat mund të angazhohet mësimdhënësi i pensionuar, caktohet nga këshilli i njësisë akademike.
5. Llogaritja e numrit maksimal të temave baçelor dhe master, sipas tabelës 3 dhe 4, brenda vitit akademik, merr parasysh vendimin për lejimin e temës nga organet kompetente, pavarësisht se kur realizohet mbrojtja e temës.

Neni 10

Punimet e diplomës baçelor dhe master në kuadër të mbinormës

1. Kompensimi i punimeve të diplomës në studimet baçelor në kuadër të mbinormës brenda vitit akademik, caktohet sipas specifikave të njësisë akademike të përcaktuara në tabelën 5.

Tabela 5.

Njësia akademike/ Fakulteti	Mentor	Kryetar ose anëtar
Filozofik	20	40
FSHMN	10	20
Filologjik	20	40
Juridik	20	40
Ekonomik	20	40
Ndërtimtarisë	10	20
FIEK	10	20
FIM	10	20
Mjekësisë	10	20
FBV	10	20
Artet e Bukura	10	20
FEFS	10	20
Edukimit	20	40
Arkitekturë	10	30

2. Kompensimi i punimeve të diplomës në studimet master në kuadër të mbinormës brenda vitit akademik, caktohet sipas specifikave të njësisë akademike të përcaktuara në tabelën 6.

Tabela 6.

Njësia akademike/ Fakulteti	Mentor	Kryetar	Anëtar
Filozofik	8	16	16
FSHMN	4	8	8
Filologjik	8	16	16
Juridik	8	18	18
Ekonomik	8	18	18
Ndërtimtarisë	4	8	8
FIEK	4	8	8
FIM	4	8	8
Mjekësisë	4	8	8
FBV	4	8	8
Artet e Bukura	4	8	8
FEFS	4	8	8
Edukimit	8	16	16
Arkitekturë	4	8	8

3. Njësia akademike siguron ndarjen proporcionale të temave baçelor dhe master në kuadër të mbinormës.
4. Mësimdhënësi i emëruar si mentor, pavarësisht pozitave tjera, në të cilat mund të emërohet në komisionet lidhur me punimin e kandidatit, kompensohet vetëm në cilësinë e mentorit. Emërimet e tilla të mentorit po ashtu nuk mund të merren parasysh në aspektin e numrit të pjesëmarrjeve në cilësinë e kryetarit/anëtarit si në tabelën 6.
5. Personeli akademik i cili në momentin e plotësimit të moshës së pensionimit ka qenë në marrëdhënie pune në UP, me rastin e vazhdimit të angazhimit, kompensohet për numrin e temave, në të cilat është mentor, anëtar ose kryetar i komisionit. Me qëllim të kompensimit, numri i temave dhe kufizimet tjera, në të cilat mund të angazhohet mësimdhënësi i pensionuar, caktohet nga këshilli i njësisë akademike.
6. Llogaritja e numrit maksimal të temave baçelor dhe master, sipas tabelave 5 dhe 6, brenda vitit akademik, merr parasysh vendimin për lejimin e temës nga organet kompetente, pavarësisht se kur realizohet mbrojtja e temës.
7. Kompensimi i temave baçelor dhe master në kuadër të mbinormës bëhet pas mbrojtjes së temës, duke llogaritur numrin e tërësishëm të temave në kuadër të normës dhe mbinormës.
8. Me qëllim të kompensimit, për programet e studimeve të integruara, kufizimit lidhur me numrin e punimeve të diplomës për normë dhe mbinormë aplikohen njëjtë sikur në programet e studimeve baçelor (themelore), sipas kësaj rregulloreje, përjashtimisht nëse përcaktohet ndryshe me programin e akredituar të studimeve.

Neni 11
Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe pozitive tjera në nivel të UP-së dhe njësive akademike

1. Personelit të emëruar apo të zgjedhur në njërën prej pozitive menaxhuese të përcaktuara në tabelën nr. 7, në përputhje me këtë rregullore, i takon shtesa mbi pagën bazë si në vijim:

Tabela 7.

Nr. rendor	Emërtimi i pozitës	Njësia	Shtesa
1	Rektor	Muaj	500 €
2	Prorektor	Muaj	450 €
3	Dekan i fakultetit	Muaj	350 €
4	Prodekan i fakultetit	Muaj	250 €
5	Profesor emeritus (pagesa bëhet deri në datën kur profesori mbush moshën 70-vjeçare)	Muaj	250 €
6	Shef/koordinator/e i qendrave profesionale në nivel qendror si dhe qendrave që themelohen nga Këshilli Drejtues	Muaj	250 €
7	Këshilltar i rektorit	Muaj	250 €
8	Koordinator ndërlidhës i UP-së për bashkëpunim me universitetet euroaziatike	Muaj	150 €
9	Koordinator për zhvillim akademik (ECTS)	Muaj	100 €
10	Drejtor i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	Muaj	120 €
11	Sekretar i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	Muaj	70 €
12	Shef i departamentit (degës)	Muaj	70 €
13	Sekretar i departamentit (degës)	Muaj	30 €
14	Kryesues i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Qendrore Universitare	Muaj	70 €
15	Anëtar i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Qendrore Universitare	Muaj	40 €
16	Instruktor në qendrën për përsosmëri në mësimdhënie për orë mësimi/trajnimi	Orë	35 €
17	Instruktor në qendrën profesionale në nivel të universitetit për orë mësimi/trajnimi	Orë	25 €

2. Shtesat funksionale për anëtarët e Këshillit Drejtues përcaktohen me Vendimin nr. 260/01B, datë 29.06.2015 të MASHTI-t, për unifikimin e pagave/shtesave të kryetarëve/kryesuesve dhe anëtarëve të këshillave drejtues të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike, që financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

- Personeli akademik nuk mund të mbajë dy pozita si ato me nr. 1 deri 13 të përcaktuara në tabelën nr.7.

Neni 12

Kompensimi për orët e mbajtura të personelit akademik në pozita menaxhuese dhe drejtuese në nivel të UP-së

- Rektorit, prorektorit, anëtarit të këshillit drejtues, i zgjedhur nga senati, dekanit, në qoftë se mban mësim, i takon kompensim deri në 6 orë në kuadër të mbinormës.
- Prodekani ka për obligim të mbajë 3 orë të normës së paraparë sipas thirrjes akademike që mban, ndërsa mund t'i mbajë deri në 6 orë në kuadër të mbinormës.

Neni 13

Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UP

- Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, u takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, si në vijim:

Tabela 8.

Nr. rendor	Emërtimi i thirrjes	Vlera në bruto
1	Bashkëpunëtorë për ligjërata (me thirrje akademike në universitete publike)	25 €
2	Bashkëpunëtorë për ligjërata (pa thirrje akademike në universitete publike)	20 €
3	Bashkëpunëtorë për ushtrime (me thirrje akademike në universitete publike)	13 €
4	Bashkëpunëtorë për ushtrime (pa thirrje akademike në universitete publike)	10 €
5	Bashkëpunëtorë-Lektor, korepetitor (me thirrje akademike në universitete publike)	13 €
6	Bashkëpunëtorë-Lektor, korepetitor (pa thirrje akademike në universitete publike)	10 €

- Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, pagesa sipas tabelës nr. 8 të këtij neni, u takon më së shumti për 8 muaj brenda vitit akademik, sipas orëve të realizuara ashtu siç e përcakton kjo rregullore.
- Lektorët të cilët angazhohen si rezultat i bashkëpunimit me ambasada dhe me agjenci shtetërore të vendeve përkatëse apo marrëveshjeve me universitete të huaja, në përputhje me këtë rregullore, pagesa nga pika 5 dhe 6 e tabelës nr. 8 të këtij neni, u takon për 12 muaj brenda vitit akademik. Angazhimi i kësaj kategorie të lektorëve bëhet nga senati për çdo vit akademik.

4. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ligjërata në nivelin baçelor, mund të angazhohen përjashtimisht edhe kandidatët me gradën e magjistrisë (Mr. Sc.) ose masterit (MA), sipas statutit dhe rregulloreve tjera në fuqi të UP-së.
5. Pagesa për kategorinë nga paragrafi 4 të këtij neni do të bëhet në lartësinë e pagesës së përcaktuar për bashkëpunëtorët për ushtrime, si në pikën 3 të tabelës nr.8.

Neni 14 **Kompensimi i profesorëve vizitorë**

1. Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve të rajonit që kufizohen me Republikën e Kosovës, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, për çdo orë të mbajtur, kompensohen 30 € bruto.
2. Profesorëve vizitorë nga vendet jashtë rajonit u takon kompensimi për çdo orë të mbajtur 40 € bruto.
3. Me qëllim të kompensimit të profesorëve vizitorë, ata duhet të angazhohen me propozim të këshillit të njësisë akademike si dhe miratimit përfundimtar nga Senati i UP-së. Angazhimi i profesorëve vizitorë mund të bëhet pas planifikimit paraprak nga njësia akademike përkatëse, para fillimit të vitit akademik.
4. Profesorit vizitor të angazhuar nuk mund t'i kompensohen më shumë se njëzetekatër (24) orë brenda muajit, të cilat mund të mbahen sipas sistemit bllok, por jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda ditës së punës.
5. Profesorit vizitor nga vendet jashtë rajonit do t'i mbuloohen shpenzimet e biletës së udhëtimit, por jo më shumë se një (1) biletë kthyesë, sipas çmimit të arsyeshëm (ekonomik).
6. Në rastet kur UP-ja ka të nënshkruar memorandume mirëkuptimi me universitete tjera, në të cilat parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitorë për cikël të kufizuar ligjëratash dhe nëse një shkëmbim i tillë është në përmasa afërsisht të njëjta për të dyja universitetet, kërkesa përkatëse nga njësia akademike mund të bëhet në çdo kohë dhe nuk ka nevojë të aprovohet në senat. Varësisht nga marrëveshja, shpenzimet lidhur me vizitat e tilla merren përsipër nga universiteti dërgues ose nga universiteti pritës.
7. Nëse marrëveshja parashihet që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni pritës, UP-ja do të mbulojë kompensimin deri në 6 orë ligjërata si në paragrafin 1, përkatësisht 2, të këtij neni, shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në nivelin siç parashihet në vendimin e qeverisë për shpenzime jashtë vendit, respektivisht sipas tarifave për vendin e institucionit, me të cilin ekziston marrëveshja si në paragrafin 6 të këtij neni.
8. Nëse marrëveshja parashihet që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni dërgues, UP-ja do t'i kompensojë stafit të vet deri në 6 orë të mbajtura në shumën prej 180 euro bruto (6*30 euro). Të gjitha shpenzimet e tjera shoqëruese

(udhëtim, akomodim, ushqim) paguhen sipas akteve ligjore në fuqi për udhëtime jashtë vendit. Shpenzimet totale nuk mund të tejkalojnë shumën prej 1000 euro bruto për një profesor vizitor dhe ato paguhen mbi pagën e rregullt që ai/ajo merr në UP.

9. UP-ja do të mbulojë të gjitha shpenzimet sipas paragrafit 6 për personelin e vet, vetëm nëse UP-ja ka një memorandum të mirëkuptimit të nënshkruar me universitetin pritës, në të cilin parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitorë.
10. Njësitë akademike kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin e profesorëve vizitorë sipas paragrafit 6 për vetëm 1 profesor në semestër, duke i dhënë përparësi personelit të rregullt akademik me thirrjen e profesorit, në rastin e qëndrimit për herë të parë.
11. Në asnjë rast një profesor vizitor nuk mund të qëndrojë më shumë se 1 herë në universitetin e njëjtë për lëndë të njëjta. Qëndrimi i përsëritur në universitetin e njëjtë, por për lëndë të ndryshme, lejohet vetëm nëse nuk ka të interesuar tjerë (përfshirë prof. asoc ose prof. ass.) për realizimin e qëndrimit në universitetin përkatës.
12. Rektori i UP-së nxjerr vendim për secilin profesor vizitor të njërive akademike, në të cilin specifikohen përgjegjësitë dhe obligimet përkatëse.
13. Buxheti i ndarë për profesorët miratohet nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të rektorit dhe rishikohet në intervale të caktuara vjetore.
14. Me kërkesën dhe arsyeshmërinë nga rektori, skema e përfitueseve nga radhët e profesorëve vizitorë mund të zgjerohet me vendim të Këshillit Drejtues, por brenda lartësisë së buxhetit të aprovuar për vitin përkatës.

Neni 15

Fondi i orëve mbinormë për profesor/mësimdhënës

1. Personeli akademik i UP-së në marrëdhënie të rregullt pune (prof. i rregullt; prof. asoc. dr.; prof. ass. dr. dhe ligjërues) mund të mbajë deri në 6 orë ligjërata mbi normë në javë, në semestrin përkatës.
2. Personeli akademik (prof. i rregullt; prof. asoc. dr.; prof. ass. dr. dhe ligjërues), i cili, përveç marrëdhënies së rregullt të punës me UP-në, është i emëruar apo zgjedhur në ndonjë post publik jashtë UP-së, nuk mund të marrë orë mbinormë në UP.
3. Përjashtim nga pika (2) bëhet për personelin akademik të Fakultetit të Mjekësisë (prof. i rregullt; prof. asoc. dr.; prof. ass. dr.) që punon në Shërbimin Spitalor Universitar të Kosovës, të cilëve iu lejohen deri në 3 orë mbi normë.
4. Për personelin akademik, njësia akademike është e obliguar që të sigurojë orë mësimore nga fusha e njëjtë ose e përafërt deri në krijimin e normës së plotë, pa rrezikuar normën e mësimdhënësve tjerë. Në rastin kur mësimdhënësit i ofrohen orë për plotësimin e normës dhe ai/ajo nuk e pranon, pagesa i bëhet proporcionalisht me numrin e orëve, të cilat i mban.

5. Më qëllim të kompensimit, norma e plotë e personelit akademik duhet të plotësohet fillimisht nga lëndët, të cilat janë të lira ose mbinormë, duke pasur parasysh vendimet për zgjedhjen e personelit akademik. Në rast se norma nuk plotësohet me lëndë të lira, atëherë e njëjta mund të plotësohet me grupe, në lëndën përkatëse, duke pasur parasysh numrin e studentëve dhe krijimin e grupeve sipas kësaj rregulloreje. Vlerësimin për përmbushjen e normës, sipas këtij neni, e bën njësia akademike.
6. Orët mbi normë nuk mund t'i barten personelit akademik, i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk u plotësohet norma e plotë me ligjërata mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë.
7. Personelit akademik i pensionuar, me rastin e angazhimit, i takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, sipas kësaj rregulloreje, por jo më shumë se 6 orë në javë, në kuadër të semestrit përkatës.

Neni 16

Fondi i orëve mbinormë për asistent, lektor dhe korepetitor

1. Personeli akademik me thirrjen asistent, lektor dhe korepetitor, i cili është në marrëdhënie të rregullt pune në UP, mund të mbajë deri në 10 orë mbi normë në javë, përjashtimisht në Fakultetin e Arteve, deri në 4 orë në javë.
2. Asistenti i cili, përveç marrëdhënies së rregullt të punës me UP-në, është i emëruar apo zgjedhur në ndonjë post publik jashtë UP-së, nuk mund të marrë orë mbinormë.
3. Orët mbi normë nuk mund t'i barten asistentit, i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk u plotësohet norma e plotë asistentëve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë.
4. Asistentëve të rregullt nuk mund t'u kompensohen orët e ligjëratave. Në raste të veçanta, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit, kur konstatohet se nuk ka mundësi të angazhimit të personelit adekuat, asistenti me doktoratë, përkatësisht me magjistraturë apo master, që ka të regjistruar doktoratën, mund të angazhohet për mbajtjen e ligjëratave në nivelin e studimeve baçelor, ndërsa bartës i lëndës mbetet profesori i lëndës përkatëse ose fushës së përafërt. Kompensimi për këtë kategori bëhet në bazë të thirrjes akademike.

Neni 17

Fondi i orëve për bashkëpunëtor të jashtëm dhe profesor vizitor

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm mund të mbajnë deri në 6 orë ligjërata në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm mund të mbajnë deri në 10 orë ushtrime në javë.
3. Profesorët vizitorë për ligjërata mund të mbajnë deri në 6 orë në javë.

Neni 18
Kompensimi për punimet e diplomës të studimeve baçelor

1. Për çdo punim diplome mbi numrin e përcaktuar në tabelën nr. 3, mësimdhënësi kompensohet siç është përcaktuar në tabelën nr. 9.
2. Mentori i emëruar nuk kompensohet edhe në cilësi të anëtarit të komisionit.
3. Kompensimi bëhet pas mbrojtjes së punimit të diplomës.

Tabela 9.

Nr. rendor	Emërtimi i komisionit	Kompensimi në vlerën bruto
1	Mentori	20 €
2	Anëtari(ët) e komisionit	10 €

Neni 19
Kompensimi për punimet e diplomës të studimeve master

1. Për çdo punim diplome mbi numrin e caktuar në tabelën nr. 4, mësimdhënësi kompensohet siç është përcaktuar me tabelën nr. 10.
2. Mentori i emëruar nuk kompensohet edhe në cilësi të anëtarit të komisionit.
3. Kompensimi bëhet pas mbrojtjes së punimit të diplomës.

Tabela 10.

Nr. rendor	Emërtimi komisionit	Kompensimi në vlerën bruto
1	Mentori	150 €
2	Kryetari i komisionit	60 €
3	Anëtari(ët) e komisionit	50 €

Neni 20
Kompensimi për punimet e diplomës në studimet e doktoratës

1. Kompensimi për mentorin dhe komisionet e doktoratës bëhet sipas tabelës 11.

Tabela 11.

Nr. rendor	Emërtimi komisionit	Kompensimi në vlerën bruto
1	Për mentorin e disertacionit të doktoratës	1,200 €
2	Për kryetar të komisionit për vlerësim të disertacionit të doktoratës	200 €
3	Për anëtar të komisionit për vlerësim të disertacionit të doktoratës	200 €
4	Për kryetar të komisionit për mbrojtje të disertacionit të doktoratës	150 €
5	Për anëtar të komisionit për mbrojtje të disertacionit të doktoratës	150 €

2. Bashkëmentorit ose anëtarit të komisionit nga universitetet, të cilat nuk janë të rajonit, shpenzimet e qëndrimit në vlerë deri 300 (treqind) euro i kompensohen nga UP-ja. UP-ja, përveç shpenzimeve të qëndrimit në vlerën e përcaktuar, kësaj kategorie ia kompenson edhe shpenzimet e udhëtimit (bileta ose derivatet), sipas çmimeve ekonomike dhe të tregut.
3. Bashkëmentorit ose anëtarit të komisionit nga universitetet e rajonit, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i kompensohen nga UP-ja, por jo më shumë se 300 (treqind) euro.
4. Për kandidatët që kanë mentor të dytë, mentori kompensohet 60%, kurse mentori i dytë 40%. Kompensimi bëhet nga shuma e caktuar për mentorin në tabelën nr. 11, duke bërë ndarjen e kësaj shume sipas përqindjes së caktuar në këtë paragraf.
5. Për kandidatët që kanë bashkëmentor, mentori kompensohet 75%, kurse bashkëmentori 25%. Kompensimi bëhet nga shuma e caktuar për mentorin në tabelën nr. 11, duke bërë ndarjen e kësaj shume sipas përqindjes së caktuar në këtë paragraf.
6. Kompensimi i përcaktuar në tabelën 11 nuk vlen për anëtarët e komisionit për vlerësimin e projektpropozimit të disertacionit të doktoratës.
7. Në rast se bashkëmentori është kryetar ose anëtar i komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temës së doktoratës, ai kompensohet vetëm si kryetar ose anëtar dhe jo si bashkëmentor.

Neni 21

Kompensimi për orët e mbajtura në studimet e doktoratës

1. Orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten në kuadër të normës dhe mbinormës, të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, orët në studimet e doktoratës vetëm në vitin akademik 2021/22 do të kompensohen në bazë të vendimit të veçantë, në nivelin siç parashihet me këtë rregullore për mbinormën (25 €/orë).
3. Numri i kandidatëve që mund t'i mentorojë një mësimitdhënës përcaktohet me rregulloren për studime të doktoratës.
4. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve profesionale (punime hulumtuese) mund të jetë një (1) orë në javë, por jo më shumë se 15 orë për semestër.
5. Ora mësimore në studimet e doktoratës në lëndët e semestrit të dytë (punimet hulumtuese) mund të kompensohet nëse në orë kanë marrë pjesë një (1) deri në pesë (5) studentë/doktorantë.
6. Varësisht nga numri i mësimitdhënësve në program për lëndën përkatëse si dhe numrin e studentëve, një mësimitdhënës nuk mund të marrë për mentorim më shumë se pesë (5) studentë në lëndën e kurseve profesionale (punimeve hulumtuese) brenda semestrit përkatës.
7. Lëndët teorike, të cilat mbahen nga dy (2) ose më shumë mësimitdhënës, kompensimi i orëve të planifikuara në këto lëndë duhet të bëhet në mënyrë proporcionale për secilin mësimitdhënës. Në secilin rast një orë kompensohet vetëm një herë.

Neni 22

Kompensimi për organet dhe komisionet në nivel të universitetit

1. Kompensimi i komisioneve në nivel të UP-së bëhet sipas tabelës nr.12 dhe në bazë të mbledhjeve të mbajtura, por jo më shumë se për dy mbledhje në muaj për një komision.

Tabela 12.

Nr. rendor	Emërtimi komisionit	Kompensimi në bruto
1	Komisioni i studimeve	58.50 €
2	Këshilli qendrorë i studimeve të doktoratës	58.50 €
3	Këshilli botues	58.50 €
4	Këshilli për cilësi	58.50 €
5	Këshilli i etikës	58.50 €
6	Komisioni i ankesave dhe parashtrësive të senatit	58.50 €
7	Komisioni për kërkesa, parashtrësia dhe ankesa të Këshillit drejtues	58.50 €
8	Komisioni statutar	58.50 €
9	Komisioni këshillëdhënës i rektorit për emërimet, rimbërimet dhe avancimet të personelit akademik	58.50 €
10	Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike	35.08 €
11	Komisioni recensues (kryetari) për një pozitë	58.50 €
12	Komisioni recensues (anëtari) për një pozitë	35.08 €

2. Kompensimi për anëtarë të senatit (përfshirë menaxhmentin qendror dhe dekanëve të njësive akademike) është në vlerë prej 70 € në muaj.

Neni 23

Kompensimi i orëve të mbajtura për lëndët që ofrohen në gjuhën angleze

1. Mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt pune, të cilët ligjërojnë në gjuhën angleze për orët e mbajtura, kompensohen në vlerë 35 €, me përjashtim të programit të gjuhës angleze në Fakultetin e Filologjisë, apo në fakultetet tjera kur lënda ligjërohet si gjuhë e huaj.
2. Kusht për realizimin e kompensimit të orës së mbajtur në gjuhën angleze është dëshmia e ofruar se në orën përkatëse ka pasur studentë ndërkombëtarë joshqipfolës dhe se ora është mbajtur në gjuhën angleze.

Neni 24

Grupet e ligjëratave dhe ushtrimeve si dhe kriteret e formimit

1. Formimi i grupeve të studentëve në studimet baçelor bëhet duke u bazuar në specifikat e njësive akademike dhe numrin e studentëve në këto njësi.
2. Duke u mbështetur në kriteret për formimin e grupeve të studentëve, njësitë akademike të UP-së ndahen në tri (3) grupe.
3. Në grupin e parë të njësive akademike hyjnë:

- 3.1. Fakulteti Filozofik;
 - 3.2. Fakulteti Filologjik;
 - 3.3. Fakulteti Juridik dhe
 - 3.4. Fakulteti Ekonomik.
4. Në grupin e dytë të njësive akademike hyjnë:
- 4.1. Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore (FSHMN);
 - 4.2. Fakulteti i Ndërtimtarisë;
 - 4.3. Fakulteti i Arkitekturës;
 - 4.4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
 - 4.5. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 4.6. Fakulteti i Edukimit.
5. Në grupin e tretë të njësive akademike hyjnë:
- 5.1. Fakulteti i Mjekësisë;
 - 5.2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
 - 5.3. Fakulteti i Artëve;
 - 5.4. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit.
6. Nëse numri i studentëve në një grup, ligjërata, ushtrime, ushtrime teorike, ushtrime laboratorike është më i vogël se maksimumi i përcaktuar, nuk mund të themelohet grupi tjetër.
7. Formimi i grupeve të reja pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje bëhet sipas vlerësimit të njësisë akademike, duke pasur parasysh nevojat sipas kësaj rregulloreje.

Neni 25

Krijimi i grupeve në studimet baçelor

1. Sipas kritereve të përcaktuara në këtë rregullore, grupet në studimet baçelor krijohen dhe funksionojnë duke u bazuar në tabelat 13,14 dhe 15.
2. Tabelat 13,14 dhe 15 janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Nëse numri i studentëve të regjistruar në vitin e dytë dhe në vitet e tjera vijuese sipas programit të akredituar është më i vogël se minimumi i përcaktuar në tabelat vijuese, atëherë numri i studentëve të regjistruar e përcakton madhësinë e grupit.

Tabela 13.
Grupi i parë

	Ligjërata	Ushtrime
F. Filozofik	Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 120	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 30
F. Filologjik	Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 120	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 30
F. Juridik	Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 120	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 40
F. Ekonomik	Obligative: min: 10 max: 120 Zgjedhore: min: 5 max: 120	Obligative/Zgjedhore: min 5 max: 40

Tabela 14.
Grupi i dytë

	Ligjërata	Ushtrime (Teorike)	Ushtrime (Laboratorike)
F.SH.M.N	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F. Ndërtimtarisë	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F. Arkitekturës	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max
F.I.E.K	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F.I.M	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12
F. Edukimit	Obligative: min 10- max: 70 Zgjedhore: min 5- max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 10-max-25	Obligative/Zgjedhore min: 6 – max 12

Tabela 15.
Grupi i tretë

	Ligjërata	Ushtrime (Teorike)	Ushtrime (Laboratorike /Klinike/Fizike)
F. Mjekësisë	Obligative: min: 10 max: 60 Zgjedhore: min: 5 max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5- max-25	Lab. Obligative/Zgjedhore: min 5 – max-10 Klinike, Obligative/Zgjedhore min: 4- max-8
F.B.V	Obligative: min: 10 max: 60 Zgjedhore: min: 5 max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5- max-25	Lab. Obligative/Zgjedhore min: 5- max-10 Klinike, Obligative/Zgjedhore min: 4- max-8
F. Arteve	Obligative: min: 10 max: 60 Zgjedhore: min: 5 max: 40	Obligative/Zgjedhore min: 5- max-25	/
F.E.F.S	Obligative: min: 10 max: 60 Zgjedhore: min: 5 max: 40	Oblig./Zgjedhore 5 deri 25	Fizike: Oblig./Zgjedh. 5 deri 10

Neni 26

Grupet e ligjëratave dhe ushtrimeve, në studimet master

1. Përcaktimi i grupeve në studimet master bëhet duke u bazuar në kriteret e kësaj rregulloreje, sipas specifikave të njësive akademike.
2. Nëse numri i studentëve të regjistruar në vitin e dytë është më i vogël se minimumi i përcaktuar në tabelat vijuese, atëherë numri i studentëve të regjistruar përcakton madhësinë e grupit.
3. Grupet e ligjëratave dhe ushtrimeve në studimet master formohen dhe funksionojnë sipas tabelave 16, 17 dhe 18, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Tabela 16.

Grupi i parë	Ligjërata (Oblig.)	Ligjërata (Zgjedh.)	Ushtrime (Oblig. /Zgjedh.)
F. Filozofik	Min. 10-Max. 60	Min. 10-Max. 30	Deri 20
F. Filologjik	Min.10 ² -Max. 60	Min. 10-Max. 30	Deri 20
F. Juridik	Min. 10-Max. 60	Min. 10-Max. 30	Deri 20
F. Ekonomik	Min. 10-Max. 60	Min. 10-Max. 30	Deri 20

² Përfshijmë programet e gjuhëve të huaja ku mësimi mund të fillojë edhe me shtatë (7) studentë.

Tabela 17.
Grupi i dytë

	Ligjërata (Oblig./Zgjedh.)	Ushtrime	
		Teorike	Laboratorike
FSHMN	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Ndërtimtarisë	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Arkitekturës	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
FIEK	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
FIM	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15
F. i Edukimit	Min. 5-Max 50	Obligative/Zgjedhore nga 5 deri 20	Obligative/Zgjedhore, nga 5 deri 15

Tabela 18.
Grupi i tretë

	Ligjërata (Oblig./Zgjedh.)	Ushtrime		
		Teorike	Laboratorike /Fizike	Klinike
F. Mjekësisë	Min. 10-Max 50	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	Obligative/Zgjedhore, deri 8
F.B.V	Min. 10-Max 50	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	Obligative/Zgjedhore, deri 8
F. Arteve	Deri 40	/	/	/
F.E.F.S	Min. 10-Max 50	Obligative/Zgjedhore, 5 deri 15	Obligative/Zgjedhore, deri 10	/

Neni 27

Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet me listat elektronike të studentëve të gjeneruara nga SEMS-i, të verifikuara dhe nënshkruara nga prodekani për mësim. Me qëllim të kompensimit, listat fizike mund të përdoren si dëshmi për mbajtjen e orës vetëm si përjashtim dhe vetëm për shkak të rrethanave objektive³, të cilat duhet të konfirmohen me shkrim nga prodekani për mësim.
2. Orët e mbajtura online arsyetohen në bazë të evidencës së regjistrimit elektronik të prezencës së studentëve, në bazë të raporteve të gjeneruara nga SEMS-i.

³ Në këtë rast "rrethanë objektive" konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike dhe problemet eventuale në SEMS, të cilat konfirmohen nga zyrtarët e IT-së në UP.

3. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe orët mbi normë të personelit të rregullt kompensohen në muajin vijues, në bazë të raporteve (elektronike) të dërguara dhe të verifikuara nga prodekani për mësim.
4. Raportet e verifikuara nga prodekani për mësim dorëzohen për pagesë në shërbimin e financave të njësisë akademike përkatëse deri me datën 5 të muajit vijues. Në rast se raportet e verifikuara të muajt paraprak nuk dorëzohen për pagesë deri me datën 5 të muajit vijues (përgjashtimisht ditëve të pushimit), kompensimi nuk mund të realizohet.
5. Raportet për orët e mbajtura më të vjetra se një muaj nuk kompensohen.
6. Ora e mbajtur konsiderohet e vlefshme dhe kompensohet, në rast se merr pjesë minimumi i studentëve, i përcaktuar për grup, sipas kësaj rregulloreje.
7. Në rast të mosmbajtjes ose mosmbajtjes me rregull të orëve, dekani i njësisë akademike, deri më 5 të muajit vijues, është i obliguar të shqiptojë sanksionet financiare, sipas kësaj rregulloreje.
8. Në rastet kur në orë nuk ka marrë pjesë asnjë student, pavarësisht që profesori/asistenti janë prezent, ora konsiderohet e pavlefshme dhe nuk kompensohet.
9. Orët e normës të cilat bien gjatë festave zyrtare të përcaktuara me ligj duhet të zëvendësohen.
10. Në rast se pa arsye personeli akademik nuk dorëzon raportin e orëve të mbajtura deri me datë 5 të muajit vijues, përgjegjësia për mosrealizim të pagesave do të bie mbi të.
11. Përgjashtimisht, në rastet kur në muajin përkatës nuk ka mjete buxhetore për pagesë, pagesa mund të shtyhet për muajt vijues.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Vlefshmëria e rregullores

1. Kjo rregullore vlen për të ardhurat personale dhe kompensimin e punës për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar në UP, shtesat sipas funksioneve, përfshirë kompensimin e anëtarëve të senatit (personeli akademik, personeli administrativ dhe studentët) si dhe kompensimin e punës së anëtarëve të komisioneve të specifikuara në këtë rregullore, të cilat emërohen brenda UP-së, duke mos përgjashtuar edhe çështjet e tjera që ndikojnë në të ardhurat personale.
2. Kjo rregullore nuk mund të zbatohet për veprimet që janë ndërmarrë dhe që prekin materien e kësaj rregulloreje, para hyrjes në fuqi të saj.

Neni 29
Dispozitat kalimtare

1. Të gjitha obligimet financiare të krijuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje kompensohen sipas rregullores nr. 2/486, për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 11.09.2017.
2. Të gjitha kufizimet e përcaktuara në këtë rregullore, sa u përket pagesave dhe çështjeve tjera, aplikohen pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 30
Shfuqizimi

1. Pas miratimit të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja nr.2/486, datë 11.09.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, rregullorja nr.817, datë 29.03.2018, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.2/486, datë 11.09.2017, për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, rregullorja nr.1/13, datë 19.04.2018, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.2/486, datë 11.09.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Neni 31
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues.


Këshilli Drejtues i UP-së
Dr. Arbëresha Neta Turjaka - kryesuese